



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2018:070902

Datë: 10.02.2020

Numri i dokumentit: 00820386

**P.nr.1014/19**

### **NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**, Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal, përmes gjyqtarës së vetme gjykuese Vjollca Buzhala, me sekretaren juridike Drita Gërmizaj, në çështjen penale ndaj të akuzuarit A.B, nga Prizreni, për shkak të veprës penale, vjedhje e rëndë nga neni 315 par.1 nën par. 1.1 lidhur me nenin 31 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prizren PP//II nr.2772-9/18 të dt.05.08.2019, pas mbajtjes së qyrtimit fillestar, në prezencën e Prokurorit të shtetit Shpend Binaj dhe të akuzuarit, me datë 01.07.2020, mori dhe shpalli publikisht këtë:

### **A K T G J Y K I M**

I akuzuari A.B nga i ati F. , emri i nënës L., e lindur K., i lindur me dt. ... në Prizren , ku edhe jeton, rr” ...”pa. nr., ka të kryer shkollën fillore, me profesion punëtor ndërtimi, i pa martuar, i gjendjes së dobët ekonomike, Shqipëtar, shtetas i R. të Kosovës.

### **ËSHTË FAJTOR**

Në mes të datave 20-22.10.2018 në orë të pacaktuar në Prizren, në rr”...” saktësisht në shtëpinë e të dëmtuarit M.H, duke vepruar në bashkëveprim dhe koordinim me të miturit L.F. dhe F.S. dhe me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete, afrohen të shtëpia e të dëmtuarit , ku e shfrytëzojnë momentin e volitshëm , mos prezencën e pronarit të shtëpisë , i cili jeton në një shtëpi tjetër dhe në orët e vona të natës , ku prezenca e njerëzve është rralluar , në atë mënyrë që fillimisht kalojnë murrin rrethues dhe futen në oborrin e shtëpisë së të dëmtuarit nga aty afrohen tek dera e hyrjes së shtëpisë , tentojnë që ta hapin me forcë , por nuk mund ta hapin dhe më pastaj i afrohen dritares së bodrumit dhe me përdorimin e forcës dhe me mjet të përshtatshëm e hapin dritaren dhe nga aty futen në brendësi të shtëpisë , pas kontrollit në vendet e ndryshme brenda në shtëpi arrin të vjedhin : një kaçavid, me dorëzngjyrë portokalli dhe të zezë , një qafore-zingjirë , bizhuteri të ndryshme , një çantë ku në të ka pasur një fleks, burrmashinë , sharrë elektrike, në unazë prej ari me mbishkrimin “ ...” 03.01.2008, e më pas pa u vërejtur largohen nga vendi i ngjarjes , me çrast të dëmtuarit i shkakton dëm material .

Me këtë ka kryer veprën penale vjedhje e rëndë nga neni 315 par.1 nën par. 1.1 lidhur me nenin 31 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Andaj , gjykata në bazë të neneve 7,8,9,10, 17, 21,38, 40,43, 46, 47, 48, 49, 69, 70, 71, dhe 72, të KPRK-së dhe neneve 248 dhe 365 të KPP-së të akuzuarit i shqipton :

### **DËNIMIN ME GJOBË**

Në shumën prej 300 euro të cilin shumë është i obliguar që ta paguajë në afat prej 15 ditëve prej plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi , nëse i akuzuari nuk dëshiron ose nuk mund ta paguajë gjobën , ky dënim do ti shëndrohet në dënim me burg ashtu që për çdo 20 euro të gjobës do të llogaritet një ditë burgim që do të thotë 15 ditë burg, dhe

### **DËNIM ME KUSHT**

Ashtu që i vërteton dënimin me burg në kohëzgjatje prej 2(dy) viteve , i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari në afat prej 4 (katër) viteve nuk kryen vepër të re penale.

I akuzuari obligohet që ti paguajë shpenzimet e procedurës penale dhe atë në emër të paushallit gjyqësor shumë prej 20 (njëzet)euro dhe 30(tridhjetë)euro në emër të programit të viktimave të krimit .

I dëmtuari M.H nga Prizreni rr” ...” pa nr. udhëzohet në kontest te rregullt civil.

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Prizren-Departamenti i Përgjithshëm, pranë kësaj gjykate ka paraqitur aktakuzën PP//II nr. 2772-9/18 të dt.05.08.2019, kundër të akuzuarit A.B, nga Prizreni, për shkak të veprës penale, vjedhje e rëndë nga neni 315 par.1 nën par. 1.1 lidhur me nenin 31 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Pas pranimit të shkresave të lëndës, gjyqtarja gjykuese me daten 01.07.2020 ka caktuar shqyrtimin fillestar , ku i akuzuari pas udhëzimeve lidhur me të drejtat të cilat i takojnë sipas ligjit, pasi që ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, e ka pranuar fajësin që i ngarkohet me aktakuzë.

I akuzuari ka deklaruar se e pranon fajsin personale si në dispozitiv të aktakuzës dhe ka shtuar se ndihet tejet i penduar për veprimin e bërë, për këso lloj vepra penale është hera e parë që akuzohet , si i ri në moshë i gjendjes së rëndë ekonomike ditën kritike, së bashku me të dy të miturit kanë hyrë në shtëpinë e lartcekur nga aty kemi marrë gjësende të përshkruara si në aktakuzë dhe i kanë ndarë së bashku, ndihet i turpëruar për këtë veprë, dhe ka garantuar gjyqtaren gjykuese se asnjëherë nuk do të kryej veprime të tilla inkriminuese apo të ngjashme sepse ka filluar të punoj, andaj kërkojë nga gjykata që ti shqiptohet një dënim më i butë pasi që është i gjendjes së rëndë ekonomike, jeton vetëm me nënën dhe 3 vëllezërit më të vegjël dhe ka filluar të punoj dhe ta mbaje familjen sepse babai nuk jeton me ta dhe kjo ka qenë arsyeja e gabuar që ka menduar që ta fitoj ndonjë euro që ta mbajë familjen e tij, e ka kupruar gabimin sepse që 3 vite është duke u përballur me pasoja të veprimeve të mëparshme sepse tani e 3 vite as kundërvajtje nuk ka kryer e lë më veprë penale.

Prokurori i Shtetit në fjalën e vet ka theksuar se pasi që e akuzuara e ka pranuar fajësinë, i cili pranim mbështetet në provat të siguruara në mënyrë të ligjshme, nuk e kundërshton pranimin e fajësisë, andaj propozon që e njëjta të shpallet fajtoreshë dhe të dënohet

sipas ligjit, por gjatë marrjes së vendimit mbi dënimin, gjykata të merr parasysh rrethanat lehtësuese në anën e saj dhe atë pranimi i fajësisë, sjellja korrekte e tyre gjatë procedurës.

Në shqyrtimin fillestar, gjykata, pas dëgjimit të palëve, ka marrë aktvendim me të cilin e ka pranuar pranimin e fajësisë, ngase ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë, në këtë aspekt, e akuzuara e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga e akuzuara, se pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e qështjes që përmban aktakuza dhe aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Andaj, në bazë të pranimin të fajësisë dhe provave tjera materiale nga shkresat e lëndës duke u bazuar në këto që u cekën më lartë, gjykata e ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

Në mes të datave 20-22.10.2018 në orë të pacaktuar në Prizren, në rr”...” saktësisht në shtëpinë e të dëmtuarit M.H, duke vepruar në bashkëveprim dhe koordinim me të miturit L.F. dhe F.S. dhe me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete, janë afruar të shtëpia e të dëmtuarit , e kanë shfrytëzuar momentin e volitshëm , mos prezencën e pronarit të shtëpisë , i cili jeton në një shtëpi tjetër dhe në orët e vona të natës , ku prezenca e njerëzve është rralluar , në atë mënyrë që fillimisht kalojnë murrin rrethues dhe futen në oborrin e shtëpisë së të dëmtuarit nga aty afrohen tek dera e hyrjes së shtëpisë , tentojnë që ta hapin me forcë , por nuk mund ta hapin dhe më pastaj i afrohen dritares së bodrumit dhe me përdorimin e forcës dhe me mjet të përshtatshëm e hapin dritaren dhe nga aty futen në brendësi të shtëpisë , pas kontrollit në vendet e ndryshme brenda në shtëpi arrin të vjedhin : një kaçavid, me dorëz-ngjyrë portokalli dhe të zezë , një qafore-zingjirë , bizhuteri të ndryshme , një çantë ku në të ka pasur një fleks, burmashinë , sharrë elektrike, në unazë prej ari me mbishkrimin “ ...” 03.01.2008, e më pas pa u vërejtur largohen nga vendi i ngjarjes , me çrast të dëmtuarit i shkakton dëm material .

Gjykata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar nga pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit i cili në shqyrtimin fillestar vullnetarisht e ka pranuar fajësinë, për shkak të cilës gjykata fare nuk ka administruar provat.

Në bazë të cekurave më lartë, gjykata ka vërtetuar se në veprimet e të akuzuarit, formohen elementet e veprës penale posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par.2 të KPRK-së nr. 06/L-74, për të cilën është edhe penalisht përgjegjës, andaj është shpallur fajtor dhe dënuar sipas ligjit duke i shqiptuar dënimin me gjobë në shumën prej 300 euro dhe **DËNIM ME KUSHT** ashtu që i vërteton dënimin me burg në kohëzgjatje prej 2(dy) viteve , i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari në afat prej 4 (katër) viteve nuk kryen veprë të re penale.

Duke u bazuar në nenin 69 dhe 70 të KPRK-së, gjykata me rastin e shqiptimit të dënimin pati parasysh të gjitha rrethanat të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimin, pasi që rrethana renduese nuk pati, si rrethana lehtësuese për të akuzuarin gjykata pati parasysh sidomos faktin se i njëjti ka pranuar fajësinë, është penduar thellë për veprën e kryer, është hera e parë që ka rënë ndesh me ligjin, është i gjendjes së dobët ekonomike, dhe ka premtuar se në të ardhmen nuk do të përsëris veprimet e tilla inkriminuese apo të ngjashme.

Sipas bindjes së gjyqtarit gjykues,denimi me gjobë dhe me kusht ndaj të akuzuarit, duke i marrë për bazë rrethanat e përmendura më lartë, është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të akuzuarit.

Gjyqtari gjykues, gjithashtu ka konstatauar se me këtë dënim mund të arrihet edhe qëllimi i dënimit, nga neni 38 të KPRK-së, i cili konsiston në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, të parandalojë personat tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Vendim për konfiskim të marihuanës u muarr në kuptim të nenit 269 par.3 të KPRK-së

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës dhe paushallin gjyqësor u mor në kuptim të nenit 450 dhe 451 par.1 dhe 2 të KPPK-së.

Vendimi mbi shpenzimet në emër të kompensimit të viktimave është bazuar në nenin 39 par.3-1 të Ligjit për Kompensim të viktimave të Krimit Nr.05/L-036.

Me sa u tha u vendos si në shqiptim të këtij aktgjykimi e në mbështetje të nenit 365 të KPP-së.

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN  
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM , DIVIZIONI PENAL**

**2018:070902,**

**G j y q t a r i**

\_\_\_\_\_  
Vjollca Buzhala

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga koha e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.